

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Parografi 4 i nenit 9 të këtij ligji sa i përket çështjes se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik përcakton si në vijim:

*“Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përm bushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”*

Eazuar në nenin e cituar si më lartë, Autoriteti Kontraktues (**Komuna e Prishtinës**), ka nevojë për sigurimin e shërbimeve, operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik (në rastin konkret Ndërmarrja Publike Banesore Sh.a. – NPB).

## KONTRATA "NË SHTËPI",

NË MES KOMUNËS SË PRISHTINËS  
më tutje "Komuna"

DHE

NDËRMARRJES PUBLIKE BANESORE SH.A.  
më tutje "NPB"

(tutje të referuar si "*Palët Kontraktuese*")

Përjashtimi i ashtuquajtur "Kontrata në shtëpi" i referohet pyetjeve të shpeshta, pyetja nr. 36, bëtuar në faqen zyrtare të KRPP-së, që autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë shërbimet e autoritetit kontraktues, pa iniciuar ndonjë procedurë të tenderimit, shih:  
[https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=HelpInfo&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=109](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=HelpInfo&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=109)

## **1. Palët kontraktuese:**

Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës ( tutje: Komuna )

Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. (tutje: NPB), Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Hajdar Hoxhaj, U.D. I K. E. NPB

## **2. Hyrje**

Kjo (KSH) lidhet në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. dhe Komunës së Prishtinës, për ofrimin e shërbimeve në mirëmbajtjen dhe rikonstruimin e këndeve të lodrave dhe terreneve sportive që gjenden në territorin e komunës.

Kjo Kontratë për shërbime (KSH) i përbën elementet standarde dhe të detyrueshme për t'u konsideruar e vlefshme.

### **2.1 Kohëzgjatja**

2.1.1 Komuna kontraktion "NPB"-në për t'i kryer të gjitha shërbimet në përputhje me këtë Kontratë.

2.1.2 Kjo KSH vlen për periudhën një vjeçare nga momenti i nënshkrimit.

2.1.3 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, palët do të i përbahen obligimeve të përcaktuara sipas kësaj kontrate.

## **3. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Kontrate është që:

3.1. Të përshkruhen kërkesat për menaxhimin cilësor të shërbimeve duke përfshirë fushëveprimin, përgjegjësitë e palëve, mënyra e pagesës, monitorimin e performancës dhe raportimin.

## **4. Fushëveprimi i shërbimit**

### **4.1. Kushtet themelore**

4.1.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, "NPB" përkujdeset për mirëmbajtjen dhe rikonstruimin e gjitha këndeve të lodrave dhe terreneve sportive që gjenden brërëda zonës së kufijve komunalë.

- 4.1.2. "NPB" e siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme për ta ofruar një shërbim të kënaqshëm.

#### *4.2. Forca madhore*

Nga "NPB" nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në pikën 2 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë forcë madhore.

- 4.2.1 Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton që përbushja e detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrëthanat. Ajo përfshin, luftën, protestat, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthime, stuhi, përmbytje.

- 4.2.2 Forca Madhore nuk përfshin një ngjarje, e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njërs palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; as një ngjarje të cilën, një palë e kujdeshme në mënyrë të arsyeshme, duhet ta kishte shmangur ose tekaluar me përbushjen e detyrimeve në këtë kontratë;

- 4.2.3 Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve për të operuar ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës

### **5. Monitorimi dhe raportimi**

- 5.1. "NPB" i harton dhe dorëzon raportet e kërkvara sipas menaxherit për mbikëqyrje i cili caktohet nga kryetari në këtë Kontratë.
- 5.2. Këto raporte verifikohen dhe monitorohen nga Komuna sipas kushteve te kësaj kontrate. Monitorimi nga Komuna përfshin edhe vizitat në terren.

### **6. Përgjegjësitë e Komunës**

- 6.1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Parqeve dhe Drejtorinë e Sportit të bëjë identifikimin e të gjitha këndeve të lodrave dhe terreneve sportive, të cilat do të mirëmbahen nga NPB sipas kësaj kontrate.
- 6.2. Komuna do t'i kontrollojë rregullisht, përmes menaxherit të caktuar dhe të përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë. Një kopje e raportit duhet t'i dorëzohet "NPB" - së.
- 6.3. Komuna në buxhetin e miratuar për Drejtorinë e Parqeve, për mirëmbajtjen e këndeve të lodrave në kategorinë buxhetore 48167 i ka të ndara

100.000€, ndërsa nga Drejtoria e Sportit për mirëmbajtjen e terreneve sportive, në kategorinë buxhetore 89412 ndahen 20.000 €.

## 7. Përgjegjësitë e NPB

- 7.1. T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë Kontratë me tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.
- 7.2. Të bëjë mirëmbajtjen dhe rikonstruimin e këndeve të lodrave dhe terreneve sportive me kohëzgjatje ashtu siç është e përcaktuar në këtë kontratë.
- 7.3. Të përgatitet dhe dorëzohet një raport për aktivitetin e shërbimit dhe gjendjen e tyre për secilin lokacion ku ndodhen ato.
- 7.4. Është përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.
- 7.5. Do të kryejë shërbimet për mirëmbajtje dhe rikonstruim në bazë të evidentimit të nevojës të komunës së Prishtinës.
- 7.6. Pas pranimit të kërkesës për ndërhyrje në mirëmbajtjen nga komuna e Prishtinës, NPB është e obliguar të intervenojë sipas kërkesës brenda 24 orëve.

## 8. Mënyra e pagesave

- 8.1. Të caktohet çmimi për njësi.
- 8.2. Në bazë të kësaj Marrëveshje pagesa do të bëhet në baza mujore, bazuar në konstatimin e menaxherit të kontratës të cilës do të bashkëngjitet fatura për shërbimin e ofruar nga NPB.

## 9. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 9.1. Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj KSH-je zgjidhen, në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë KSH dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

- a. **Nivel i parë:** Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtron me shkrim Bordit të Drejtorëve/"NPB"-së përkatëse, anëtarët e të cilët do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.

- b. Nivel i dytë: Pas nivelistë parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit Komunal të Aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.
- c. Nivel i tretë: Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis "NPB"-së dhe Komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore e Prishtinës), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë gjykata.
- 9.2. Deri sa te merret vendim e te qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "NPB" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj Kontrate.

## 10. Rishikimi i Kontratës

- 10.1. Kjo Kontratë do të rishikohet sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Prishtinës.
- 10.2. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit së kësaj Kontrate duhet te dakordohet nga te dyja palët.

## 11. Hyrja në fuqi

Kjo Kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve kontraktuese.


## 12. Nënshkrimi i Kontratës

Kjo Kontratë do të nënshkruhet në tri (3) kopje identike, nga një (1) kopje për secilën palë në këtë marrëveshje, dhe një (1) kopje për Drejtorinë e Financave të komunës së Prishtinës.

Prishtinë më, 28/08/2019

Kryetari i Komunës së Prishtinës

z. Shpend Ahmeti



Drejtori i NPB

z. Hajdar Hoxhaj

